

Raporti Vjetor 2023

Prill, 2024



RAPORTI VJETOR 2023



Vizitoni ueb faqen tonë
www.dplus.org

Zbuloni më shumë për publikimet tona të fundit,
lajmet, infografikat online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@DemocracyPlus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

Zyrat tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr.92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org

Rreth Demokraci Plus (D+)

Demokraci Plus (D+) është organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në mars të vitit 2016. D+ është e përkushtuar për krijimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politike, rritjes së llogaridhënies dhe ndikimit në proceset e vendimmarrjes. Ne tentojmë integrimin e teknologjisë informative në të gjitha përpjekjet tona, kjo për të nxitur përdorimin e internetit, i cili ka rol të rëndësishëm në demokratizimin e një shoqërie.

D+ synon që të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike, si dhe përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore. Po ashtu D+ ndërmerr iniciativa që kanë për qëllim afrimin e vendimmarrësve më afër qytetarëve përmes hulumtimeve të politikave, lehtësimit të dialogut apo komunikimit dhe edukimit publik.

Gjatë vitit 2023, D+ ka vazhduar të punojë në ndërtimin e një kulture demokratike përmes aktiviteteve të shumta të cilat kanë pasur synim ndikimin në vendimmarrje, forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në politikbërje si dhe përmirësimin e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

Ky raport paraqet një përmbledhje të aktiviteteve të mbajtura gjatë vitit 2023 nga D+ dhe ndikimin që ato kanë pasur në përmbushjen e misionit tonë.

Vizioni

Qeverisje dhe shoqëri ku kultura dhe vlerat demokratike janë normë.

Misioni

D+ angazhohet për zhvillimin e një shoqërie demokratike, përmes ndikimit në vendimmarrje dhe fuqizimit të pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave publike.

Programet

1 Qeverisje e Mirë

2 Sundimi i Ligjit

3 Partitë Politike dhe Zgjedhjet

1. Kontributi në politika publike

1.1 Mbështetja e Kuvendit të Kosovës në monitorimin e zbatimit të tetë (8) ligjeve

Gjatë vitit 2023, D+ ka mbështetur me ekspertizë grupe punuese të tri (3) komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës:

- I** Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit, dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në hartimin e katër (4) raporteve të monitorimit të zbatimit të ligjeve;
 1. Ligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim;
 2. Ligjin nr. 02/L-65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes;
 3. Ligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe
 4. Ligjit nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave.
- II** Komisionin për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim në hartimin e tri raporteve të monitorimit të zbatimit të ligjeve;
 1. Ligjin nr.2003/5 për Farërat;
 2. Ligjin nr. 04/L-114 për Pasurimin e Miellit;
 3. Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës.
- III** Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në hartimin e një raporti të monitorimit të zbatimit të ligjit:
 1. Ligjin nr. 04/L-156 për kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit.
- IV** Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport në hartimin e një raporti të monitorimit të zbatimit të ligjit:
 1. Ligjin nr. 05/L-90 për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116.

1.2 Angazhimi i 16 praktikantëve në komisione parlamentare në Kuvendin e Kosovës

D+ gjatë vitit 2023 ka vazhduar mbështetjen e komisioneve parlamentare në kryerjen e detyrave të përditshme përmes angazhimit të 16 praktikantëve në komisione të ndryshme parlamentare të Kuvendit të Kosovës. Praktikantët kanë asistuar stafin e komisioneve në kryerjen e punëve të përditshme, siç janë organizimi i mbledhjeve dhe kryerja e hulumtimeve për temat të cilat trajtohen në komision. Ky ka qenë viti i gjashtë me radhë që D+ angazhon praktikantë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

1.3 Përfshirja e grupeve të marginalizuara përmes takimeve konsultative në komentimin e gjashtë (6) projektligjeve dhe dhjetë (10) rregulloreve komunale

D+ përmes njëzet takimeve konsultative ka angazhuar 241 qytetarë në politikë-bërje, konkretisht në procesin e hartimit të dhjetë (10) projektligjeve dhe dhjetë (10) rregulloreve komunale të cilat prekin jetën e grupeve të marginalizuara në Kosovë. Komentet dhe rekomandimet, 104 gjithsejtë në projektligje dhe 128 në draft rregullore komunale, D+ i ka vendosur në platformën e konsultimeve publike dhe i ka dërguar përmes e-mail-it tek zyrtari përgjegjës në ministri/komunë.

D+ monitoron në vazhdimësi platformën e konsultimeve publike, për të parë nëse ministritë/komunat kanë marrë parasysh komentet e dala nga takimet konsultative me grupe të marginalizuara. Rezultatet deri në kohën kur po shkruhet ky raport janë:

- **Niveli qendror/ministritë** - 20 komente të pranuar.
- **Niveli lokal/komunat** - 31 komente të pranuar.


1.4 Inkurajimi i komunave për publikim të draft politikave në platformën e konsultimeve publike

Përmes avokimit të zyrtarët komunal, D+ ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e numrit të komunave që përdorin platformën e konsultimeve publike, respektivisht në rritjen e numrit të publikimit të draft politikave lokale në platformë. Në vitin 2020 vetëm komuna e Rahovecit ka publikuar dokumente në platformën për konsultime publike, ndërsa në vitin 2021 vetëm tri komuna e kanë përdorur këtë platformë (Rahoveci, Peja dhe Malisheva).

Si rezultat i avokimit të D+, në vitin 2023, numri i komunave që e përdorin platformën e konsultimeve publike ka arritur në 26 komuna. Për krahasim, numri i dokumenteve për konsultim me publikun të vendosura në platformë nga ana e komunave në vitin 2020 ka qenë 5, në vitin 2021 ka qenë 18, ndërsa në vitin 2023 kanë qenë rreth 352 dokumente të publikuara në platformën e konsultimeve publike.

Si rezultat i avokimit të D+, në vitin 2023, numri i komunave që e përdorin platformën e konsultimeve publike ka arritur në 26 komuna.

Për krahasim, numri i dokumenteve për konsultim me publikun të vendosura në platformë nga ana e komunave në vitin



1.5 Kontributi në promovimin e procedurave të drejta administrative për qytetarë dhe biznese

Përmes projektit “Promovimi i procedurave të drejta administrative për qytetarët dhe bizneset”, i cili përfshin dy komponente, asistim në zbatimin e Programit të qeverisë për zvogëlimin dhe parandalimin e barrës administrative për qytetarë dhe biznese, si dhe avokimin për të drejtat e qytetarëve për kompensim në rast të dëmit të shkaktuar nga autoritetet publike në vend, D+ gjatë vitit 2023 ka dhënë kontribut në aktivitetet që përfshijnë:


- Monitorimin e dhjetë (10) rasteve që kanë të bëjnë me padrejtësitë dhe dëmet e shkaktuara nga organet publike kundrejt individëve privat.
- Hartimi i tri (3) raporteve të shkurtra që pasqyrojnë rezultatet e monitorimit, siç janë:
 1. Kompensimi nga Autoritetet Publike: Monitorimi i sfidave ligjore në rastet e pensioneve të personave me aftësi të kufizuar;
 2. Kompensimi nga Autoritetet Publike: Monitorimi i Rasteve për Invalid të Luftës dhe Pension Familjar;
 3. Kompensimi nga Autoritetet Publike: Rastet e Pensionit Kontributpagues dhe Kompensimi për Punonjësit e Arsimit në vitet e '90.
- Realizimi i një ankete rreth njohurive të qytetarëve lidhur me të drejtën e tyre për kompensim.
- Publikimi i dy (2) analizave lidhur me procedurat e drejta administrative për qytetarë dhe biznese:
 1. Rishikimi i legjislacionit lidhur me të drejtën për kompensim në rastet e dëmit të shkaktuar nga autoritetet publike në Kosovë;
 2. Drejt shërbimeve publike të orientuara nga përdoruesi në Kosovë.
- Organizimi i një takimi vjetor me komunitetin e biznesit për të diskutuar nevojat e tyre konkrete dhe shqetësimet lidhur me reduktimin e barrës administrative, prezantimin e praktikave të mira nga institucione të ndryshme dhe ndarjen e njohurive.
- Realizimi i dy debateve televizive me ekspertë të fushave; njëri debat kishte për qëllim trajtimin e rasteve të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga autoritetet publike, ndërsa tjetri zbatimin e programit për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative.
- Publikimi i dy videove, njëra lidhur me zbatimin e Programit për zvogëlimin dhe reduktimin e barrës administrative, ndërsa tjetra për informim dhe vetëdijësim të qytetarëve për kompensim në rastet e dëmit të shkaktuar nga organet publike.

1.6 Hulumtim i opinionit publik rreth informimit për të drejtat e tyre për kompensim nga ana e institucioneve publike

D+ ka realizuar një hulumtim të opinionit publik për të vlerësuar nivelin e informimit të qytetarëve lidhur me të drejtën e tyre për kompensim nga ana e institucioneve publike.

Gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë se 60.2% e qytetarëve në Kosovë nuk janë në dijeni për të drejtën e tyre për kompensim në rast se kjo e drejtë iu është shkelur nga ana e institucioneve publike. Pjesa dërrmuese e qytetarëve (91.7%), nuk e kanë kërkuar asnjëherë këtë të drejtë. Ndërsa, 61.5% e qytetarëve nuk e dijnë se ku mund ta kërkojnë të drejtën e tyre për kompensim.

1.7 Monitorimi i dëgjimeve publike dhe buxhetore



Në kuadër të Aktivitetit të Kontratës Sociale, në vitin 2023 D+ ka monitoruar 98 dëgjime publike, në komunat si në vijim:

Komuna	Numri i dëgjimeve publike të monitoruara
Prishtinë	20
Prizren	14
Gjiilan	18
Suharekë	17
Obiliq	14
Ferizaj	8
Vushtrri	1
Gjakovë	1
Viti	5

Në kuadër të këtij aktiviteti, D+ ka asistuar në organizimin e procesit të buxhetimit me pjesëmarrje. Numri i pjesëmarrësve në këtë proces ishte:

Komuna	Numri i pjesëmarrësve
Prishtinë	256
Prizren	139
Gjiilan	548
Obiliq	26
Suharekë	361

1.8 Organizimi i 58 takimeve për çështje të komunitetit në pesë (5) komuna

D+ ka lehtësuar mbajtjen e 58 takimeve të grupeve të komunitetit për secilën nga çështjet e planifikuara në agjendën e Kontratës Sociale. Komunitat në të cilat janë mbajtur takimet janë:

Komuna	Numri i takimeve të mbajtura
Prishtinë	5
Prizren	12
Gjilan	10
Suharekë	15
Obiliq	16

Gjithashtu, janë realizuar me sukses pesë punëtori interaktive në pesë komuna: Gjakovë, Ferizaj, Vushtrri, Kamenicë, Viti. D+ ka asistuar në identifikimin e grupeve të ndryshme qytetare si dhe lehtësimin e sesioneve të ndryshme në punëtori.

1.9 Vlerësimi i zbatimit të drejtësisë procedurale në gjykatat themelore dhe degët e tyre në Kosovë

Gjatë vitit 2023, D+ ka vlerësuar zbatimin e drejtësisë procedurale në të shtatë (7) Gjykatat Themelore dhe 18 degët respektive në Kosovë, si dhe ka ofruar rekomandime politikash të bazuara në hulumtime për të përmirësuar zbatimin e drejtësisë procedurale në çdo gjykatë. Raportet e publikuara nga rezultatet e hulumtimit janë:

1. Raport vlerësimi mbi aplikimin e drejtësisë procedurale në tetëmbëdhjetë degët e gjykatave në Kosovë (Pjesa II);
2. Raportet për zbatimin e drejtësisë procedurale në degët e gjykatave të Ferizajit, Mitrovicës, Prishtinës, Gjakovës, Prizrenit dhe Gjilanit.
3. Vlerësim mbi Aplikimin e Drejtësisë Procedurale në Gjykatat Themelore 2021-2023: Analizë Krahasuese.

2. Monitorimi i prokurimit publik

2.1 Katër raporte të publikuara nga monitorimi i 43 tenderëve

D+ ka vazhduar monitorimin e procedurave të prokurimit publik si dhe informimin e qytetarëve për keqpërdorimin e parasë publike, përmes analizimit dhe monitorimit të 43 tenderëve.

Në katër (4) raportet e publikuar janë të përfshirë 16 tenderë, të cilët janë dhënë nga 13 Ndërmarrje Publike lokale dhe regjionale. Ndërsa, 27 tenderë janë të përfshirë në një raport të ndarë, ku autoritete kontraktuese janë tetë (8) komuna dhe Ministria e Shëndetësisë. Raportet e publikuara janë:

1. Monitorimi i prokurimit publik në ndërmarrjet publike: Prishtina Parking, Trafiku Urban, Kuzhina Qendrore dhe KRU Prishtina. [↗](#)
2. Monitorimi i Prokurimit Publik në Ndërmarrjet Publike: KRM Ekoregjioni, Hidroregjioni Jugor, Ndërmarrja Publike Banesore dhe Hortikultura. [↗](#)
3. Monitorimi i prokurimit publik në ndërmarrjet publike (tetor – dhjetor 2023). [↗](#)
4. Monitorimi i Prokurimit Publik në Ndërmarrjet Publike: Termokosi, KRU Bifurkacioni, Trafiku Urban dhe Pallati i Rinisë. [↗](#)
5. Raporti i Monitorimit të Prokurimit. [↗](#)

Sukses i shënuar në këtë kontekst ishte identifikimi i parregullsive në monitorimin e procedurave të prokurimit publik të tenderit të iniciuar nga Kuzhina Qendrore për Furnizim dhe Montim të Paneleve Solare (vlerë 36 mijë euro), i cili përmbante shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

Pas publikimit të raportit nga D+, Organi Shqyrtues i Prokurimit (tutje OShP), konfirmoi të gjeturat duke anuluar dhënien e këtij tenderi. Në lidhje me shkeljet në këtë tender të cilat u evidentuan nga D+, po ashtu iu hoq certifikimi për një vit zyrtarit të prokurimit në Komunën e Prishtinës. Në të njëjtin raport, D+ vërtetoi se tenderi i ndërmarrjes publike “Prishtina Parking” përmbante gabime esenciale që pamundësonin konkurrencën e

lirë. Pas gjetjeve të D+, kjo ndërmarrje pranoi gabimin e bërë duke e konsideruar të pa qëllimshëm.

Po ashtu, në gjetjet e raportit të dytë lidhur me tenderin e dhënë nga Ndërmarrja Publike Banesore për vlerësimin e pronave dhe qirave të ndërmarrjeve publike, D+ konkludoi se administrimi i këtij tenderi (në vlerë 23 mijë euro), përmbante shkelje esenciale të LPP-së. Pas publikimit të raportit, OShP konfirmoi këto të gjetura duke anuluar vendimin e kësaj ndërmarrje dhe duke e kthyer lëndën në ri-vlerësim.

2.2 Monitorimi i lidhjes së marrëveshjeve për shërbime të veçanta nga institucionet publike të nivelit qendror

D+ vazhduar monitorimin e kontraktimit të konsulentëve nga ana e institucioneve publike përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta. Në raportin e publikuar me gjetjet e monitorimit, janë të përfshira nëntë (9) autoritete kontraktuese, përfshirë dy lloje të kontratave: grupi i parë i kontratave ka të bëjë me shërbimet që kontraktohen në emër të konsulentëve/ekspertëve/këshilltarëve, mirëpo realisht punët e kontraktuara janë punë të zakonshme administrative, që janë përgjegjësi e stafit të punësuar në institucione. Ndërsa grupi i dytë i kontratave ka të bëjë me përfaqësimin ligjor të institucioneve, kontraktimi i të cilave ka krijuar pozita paralele sepse të gjitha institucionet kanë zyrat ligjore ose avokatin publik.

2.3 Artikuj hulumtues

Në kuadër të fushës së prokurimit publik, D+ gjithashtu ka angazhuar tre gazetarë që mbulojnë fushën e prokurimit publik, të cilët kanë përgatitur artikuj hulumtues rreth aktiviteteve të prokurimit publik të tri institucioneve. Artikujt hulumtues të përgatitur gjatë këtij viti ishin:

- Kompanitë me dyshime për tenderin mbi gjysmë milion euro të Ministrisë së Punëve të Brendshme; [↗](#)
- Me mbi 700 mijë euro punë dhe dy vjet vonesa, uji mbetet mbi nënkalim; [↗](#)
- Tenderi 2.5 milionësh për Operën përfundon në OShP, nën dyshimet për favorizim të kompanisë fituese. [↗](#)

2.4 Publikimi i pesë (5) raporteve të shkurtra

Në aspekt të përmirësimit të politikave, dhe rritjes së transparencës në prokurimin publik në Kosovë, D+ ka hartuar pesë (5) raporte të shkurtra, të cilat analizojnë shkeljet më të përsëritura gjatë procedurave të prokurimit publik. Të gjitha rekomandimet u janë komunikuar institucioneve përkatëse. Raportet e publikuara janë:

1. Lista e Zezë si mjet për parandalimin e keqpërdorimeve në prokurimin publik;
2. Përdorimi i kontratave një burimore (të negociuara) në prokurimin publik;
3. Problemet kryesore në zbatimin e planeve vjetore të prokurimit publik në ndërmarrjet publike;
4. Shkarkimi i pazakontë i anëtares së bordit të OShP-së: Sa u respektua ligji?;
5. Mungesa e ndjekjes penale për rastet e falsifikimit të dokumenteve në proceset e prokurimit publik.

Rekomandimi i raportit të parë, për ndërlidhjen automatike të Listës së Zezë me Platformën E-Prokurimi është adaptuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, ku tashmë një praktikë e tillë është duke u zbatuar.

2.5 Monitorimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit

D+ ka vazhduar monitorimin e seancave të OShP-së. Monitoruesit e D+ kanë vëzhguar vendimet dhe praktikatat e OShP-së për të vlerësuar paanshmërinë e këtij mekanizmi në trajtimin e ankesave të paraqitura në këtë institucion. Gjetjet e monitorimit të seancave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 janë pasqyruar në raportin e publikuar “Organi Shqyrtues i Prokurimit: Monitorim dhe rekomandime (janar - qershor 2023)”. Rekomandimi i cili është marrë parasysht nga OShP-ja

e i cili është në proces të ndryshimit, por që nuk ka përfunduar, është caktimi i ekspertëve shqyrtues të cilët angazhohen për të trajtuar pretendimet ankimore të operatorëve ankues, në momentin që pranohet ankesa në OShP. Deri tani caktimi i ekspertëve është bërë në mënyrë gjysmë-automatike, pasi sistemi elektronik i cili është i integruar brenda këtij organi, fillimisht ka rekomanduar tre emra për ekspert shqyrtues, ndërsa administrata ka zgjedhur në fund njërin prej tyre. Rekomandimi i D+ ka qenë që sistemi të modifikohet dhe i njejtë të përzgjedhë në mënyrë automatike një emër, pa pasur nevojë për përzgjedhje manuale nga ana e administratës. Ky ndryshim do të rriste transparencën.

2.6 Mbajtja e takimeve avokuese për të përmirësuar procedurat e prokurimit publik

Në kuadër të politikave avokuese, D+ka mbajtur 20 takime avokuese me përfaqësues të ministrive, ndërmarrjeve publike, Zyrës Kombëtare të Auditimit, deputetë të Kuvendit të Kosovës, organizata të shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë, për të diskutuar rreth gjetjeve të dala nga pesë (5) raportet e D+ lidhur me prokurimin publik.

2.7 Realizimi i pesë (5) videove lidhur me gjetjet e raporteve

D+ ka publikuar pesë (5) video informuese, tri (3) prej të cilat kanë pasqyruar gjetjet e raporteve të monitorimit të prokurimit publik të 13 ndërmarrjeve publike. Ndërsa, dy (2) video të tjera informojnë qytetarët për të drejtën e tyre për kompensim në rast të dëmit të shkaktuar nga autoritetet publike, dhe për reduktimin e barrës administrative. Videot e publikuara janë:

1. Monitorimi i prokurimit publik në ndërmarrjet publike lokale dhe rajonale nga D+.
2. Monitorimi i prokurimit publik në ndërmarrjet publike lokale dhe rajonale (prill - qershor, 2023).
3. Shkeljet e ndërmarrjeve publike në prokurim publik.
4. Si të kërkoni të drejtën tuaj për kompensim në rast të dëmit të shkaktuar nga autoritetet publike?
5. Çfarë paraqet Barra Administrative për Qytetarët dhe Bizneset në Kosovë?

3. Përprojekjet për parandalimin e përhapjes së lajmeve të rreme

3.1 Koalicioni Kosovar kundër Dezinformimit

D+ në vitin 2023 është bërë pjesë e Koalicionit Kosovar kundër Dezinformimit. Ky Koalicion ka për qëllim të avokojë dhe të mbështesë rritjen e vetëdijes dhe ndërtimin e kapaciteteve të shoqërisë kosovare për t'u përballur me sfidat e dezinformimit dhe të ndërtojë një shoqëri ku informacioni i saktë, i plotë dhe me kohë është bazë e informimit.

3.2 Organizimi i sesioneve informuese për identifikimin e lajmeve të rreme

D+ në bashkëpunim me BIRN Kosova kanë mbajtur sesione informuese me rreth 365 të rinjë në 15 komuna të Kosovës: Skënderaj, Drenas, Kamenicë, Obiliq, Gjakovë, Ferizaj, Vushtrri, Dragash, Viti, Gjilan, Klinë, Mitrovicë, Rahovec, Suharekë dhe Podujevë.

Qëllimi kryesor i këtyre sesioneve informuese ishte ofrimi i njohurive dhe informatave për të rinjtë lidhur me identifikimin e lajmeve të rreme, mënyrat e trajtimit të tyre si dhe procedurat e raportimit.



Në kuadër të informimit të publikut rreth punës së institucioneve publike si dhe aktiviteteve të D+, stafi i D+ ka pasur mbi **60 paraqitje mediale**, në formë të shkruar, intervista për media, si dhe pjesëmarrje në debate televizive.

3.3 Rreth 100 të rinj informohen për edukimin medial përmes bootcamp-it të organizuar nga D+

Bootcamp-i për edukimin medial ka bashkuar rreth 100 të rinjë nga komunitete të ndryshme që jetojnë në Kosovë për të mësuar mbi dezinformimin, mendimin kritik dhe mjetet për të luftuar dezinformimin dhe gjuhën e urrejtjes. Me një kombinim të folësve të angazhuar për të rinjtë dhe punëtorive interaktive, D+ në partneritet me UNDP-në në Kosovë ka ndikuar në fuqizimin e të rinjëve për të luftuar lajmet e rreme dhe për të promovuar edukimin mediatik.

3.4 Paraqitjet mediale

Në kuadër të informimit të publikut rreth punës së institucioneve publike si dhe aktiviteteve të D+, stafi i D+ ka pasur mbi 60 paraqitje mediale, në formë të shkruar, intervista për media, si dhe pjesëmarrje në debate televizive. Në kuadër të paraqitjeve, D+ ka reaguar rreth çështjeve të ndryshme të politikave publike duke dhënë opinione dhe rekomandime. Gjithashtu përmes paraqitjeve mediale kemi njoftuar publikun për punën dhe aktivitetet që i realizojmë në kuadër të projekteve që zbaton D+.



4. Ndikimi i D+ në Politika Mjedisore

4.1 Java Globale e Reciklimit

Gjatë Javës Globale të Reciklimit, D+ ka mbajtur diskutime publike së bashku me qytetarët e komunës së Graçanicës. Në këtë takim është diskutuar për rolin e rëndësishëm që ata kanë në ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në shtëpitë e tyre. Ky diskutim është mbajtur në kuadër të Aktivitetit të USAID Riciklimi ka Rëndësi - Graçanicë, i cili zbatohet nga D+ në partneritet me Communication for Social Development (CSD) dhe Roma Versitas Kosovo (RVK).

Gjatë Javës Globale të Reciklimit, D+ ka mbajtur diskutime publike së bashku me qytetarët e komunës së Graçanicës.





4.2 Hapja e Qendrës Burimore për mbledhësit jo formal

Hapet Qendra Burimore për mbledhësit joformal të mbeturinave për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian!

D+ në partneritet me Communication for Social Development dhe Roma Versitas Kosovo ka mirëpritur grupin e parë të mbledhësve joformal të cilët do të mbështeten me paisje të punës. Qendra Burimore shumëdimensionale me lokacion në Graçanicë ofron shërbime të integruara, duke përfshirë trajnime, pajisje, informacione dhe burime që mbështesin mbledhësit joformal për më shumë siguri dhe efikasitet gjatë punës së tyre.

4.3 Trajnim për mbledhësit joformal të mbeturinave nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Graçanicë

Është mbajtur trajnimi i parë për mbledhësit joformal të mbeturinave nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Graçanicë.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të mësojnë se si t'i shfrytëzojnë mundësitë financiare që vijnë me formalizimin e biznesit të tyre dhe cilat janë praktikatat më të mira për mbrojtjen e shëndetit gjatë grumbullimit të mbeturinave.

4.4 Mbledhësit jo-formal vizitojnë kompani të riciklimit

Në kuadër të Aktivitetit të USAID Riciklimi ka Rëndësi - Graçanicë, D+ së bashku me mbledhësit joformal të mbeturinave nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, mbajtën takime me kompani private që merren me riciklim.

4.5 Shpërndahen mjete dhe veshje të punës për mbledhësit joformal të mbeturinave

D+ ka vazhduar aktivitetet me projektin e riciklimit, duke bërë shpërndarjen e mjeteve të punës për mbledhësit joformal të mbeturinave. Gjithashtu, në kuadër të këtij projekti është mundësuar edhe dorëzimi i makinerive të punës për mbledhësit joformal të mbeturinave të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Këto pajisje do të rrisin efikasitetin e punës gjatë mbledhjes, transportimit dhe përpunimit të materialeve të riciklueshme në Graçanicë.



4.6 Publikohet hulumtimi “Nga politika në praktikë: Sfidat e ndotjes së lumenjve dhe menaxhimit të mbeturinave në Kosovë”

D+ në bashkëpunim me BIRN Kosova, Qendrën Avokuese për Kulturë Demokratike dhe Shoqatën Gora-zhdevac Media Group, ka kryer një studim mbi ruajtjen e monumenteve natyrore, lumenjve, dhe menaxhimin e mbeturinave. Disa gjetje të këtij raporti janë:

- Ndikimi më i madh në ndotjen e lumenjve vjen nga shpërndarja e ujërave të zeza nga banesat dhe bizneset.
- Fshatrat që ndodhen afër lumenjve vazhdojnë të kenë mungesë të sistemeve të kanalizimit.
- Kosova nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, administrative dhe financiare për të përmbushur standardet e Bashkimit Evropian në lidhje me ujën, mjedisin dhe ndikimin e klimës.

4.7 Publikohet studimi: “Përballueshmëria e çmimeve të cigareve në mesin e duhanpirësve të moshës madhore në Kosovë”

D+ ka publikuar rezultatet e **studimit** mbi përballueshmërinë e konsumit të duhanit dhe sjelljen e duhanpirësve të personat e moshës madhore në Kosovë.

Hulumtimi tregon se përballueshmëria më e ulët e duhanit është e lidhur me reduktim të konsumit të duhanit në Kosovë. Rezultatet konfirmojnë me konsistencë se një zvogëlim prej një-përqind në përballueshmëri të duhanit çon në zvogëlim prej tre-përqind në konsumin e duhanit.

4.8 Raport - Fillimi i duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë

D+ ka publikuar edhe një raport tjetër që ka të bëjë me fillimin e duhanpirjes tek të rinjtë në Kosovë. Të gjeturat e këtij raporti tregojnë se:

- Ekspozimi i të rinjve në duhan nga personat që e konsumojnë, si prindërit apo shoqëria mund të jetë një shtysë për ta që ta fillojnë konsumimin e tij.
- Në çdo 1% të rritjes së çmimit të duhanit, zvogëlohet me 65% konsumi apo blerja.
- Nëse pjesa më e madhe e shoqërisë që rrethon të riun konsumon duhan, ka një rritje prej 100% të probabilitetit që personi do fillojë konsumin gjithashtu.

4.9 Raportimet dhe ndreqjet në platformën ndreqe.com

Gjatë vitit 2023, në platformën ndreqe.com janë raportuar rreth 481 probleme me mbeturina, gropa në rrugë, trotuare të dëmtuara, ndriçim publik, ujëra të zeza, shenja të rrugës, ambient etj. Nga të gjitha këto raportime, brenda vitit janë sanuar 138 probleme të tilla nga 38 komuna të Kosovës.

5. Aktivitete të tjera

5.1 Konferenca “Mundësi më të mira punësimi për punëtorët sezonal në Kosovë”

D+ ka organizuar konferencën “Mundësi më të mira punësimi për punëtorët sezonal në Kosovë.” Kjo konferencë mbledhi përfaqësues të institucioneve shtetërore, Ambasadës Gjermane si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe kishte për qëllim prezantimin e raportit final rreth angazhimit të punëtorëve sezonalë në sektorin e bujqësisë në Kosovë. Disa nga rekomandimet e dala nga raporti për të lehtësuar formalizimin e punëtorëve sezonal në këtë sektor kanë qenë:

- Definimi i punës sezonale brenda kornizës ligjore;
- Deklarimi i punëtorëve sezonal në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK);
- Punëtorët duhet të deklarohen para se të fillojnë punën, ose më së voni në të njëjtën ditë para fillimit të punës.

5.2 Formalizimi i punëtorëve sezonal në sektorin e bujqësisë

D+ ka hartuar një raport lidhur me kornizën ligjore të punësimit sezonal. Gjetjet dhe rekomandime të këtij raporti janë prezantuar në grupin punues të formuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Prezantimi u fokusua te mundësitë më të mira të punës sezonale, identifikimin e sfidave ligjore, ndryshimin e ligjeve ekzistuese apo hartimin e një ligji të ri që rregullon në mënyrë specifike këtë fushë.

Në kuadër të projektit për formalizimin e punëtorëve sezonal, D+ ishte pjesë e konferencës “Shkëmbimi rajonal mbi praktikën e mira të rregullimit të punës sezonale në rajonin e Ballkanit Perëndimor.” Në këtë aktivitet morën pjesë akterë të Ballkanit Perëndimor, të cilët shkëmbyen përvojat e tyre për rregullimin e punës sezonale në sektorët e bujqësisë, turizmit, hotelierisë dhe sektorë të tjerë potencialë, me synim të rritjes së mundësive të punësimit në vendet e Ballkanit Perëndimor.





5.3 Takim: “Sfidat dhe nevojat e komunitetit të biznesit për zvogëlim të barrës administrative gjatë ndërveprimit të tyre me Administratën Tatimore të Kosovës”

Në kuadër të projektit “Promovimi i procedurave të drejta administrative për qytetarë dhe biznese” i cili mbështetet nga zyra e BE-së në Kosovë, D+ ka mbajtur takim me komunitetin e biznesit me temën: “Sfidat dhe nevojat e komunitetit të biznesit për zvogëlim të barrës administrative gjatë ndërveprimit të tyre me Administratën Tatimore të Kosovës”.

Në këtë takim u diskutua mbi nevojat dhe sfidat me të cilat përballen bizneset gjatë ndërveprimit të tyre me ATK-në, dhe se si procedurat dhe rregullat mund të thjeshtësohen më tej për të përmirësuar lehtësinë e operimit për bizneset.

5.4 Takimet e të rinjve me deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Gjatë vitit 2023, D+ ka organizuar diskutime mes deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të rinjve. Temat e diskutimit ishin të fokusuara kryesisht në angazhimin e të rinjve në politikë, ndikimin e komisioneve parlamentare në përmirësimin e politikave publike, reformat në drejtësi, mandatin e lirë të deputetëve, migrimin e të rinjve, e shumë pyetje të tjera të parashtruara nga të rinjtë.

5.5 Pasqyrimi i gjetjeve nga monitorimi i 27 tenderëve në një artikull për media

D+ në bashkëpunim me BIRN Kosova kanë monitoruar 27 tenderë në kuadër të projektit “Mbështetja e OJQ-ve për të monitoruar aktivitetet e prokurimit në komuna dhe MSh-së”, të mbështetur nga aktiviteti për Integritet në Komuna i USAID. Një prej shkeljeve më të shpeshta që është evidentuar gjatë këtij monitorimi ka qenë vendosja e kriterëve diskriminues, kriterëve shumë të larta për projektin apo emërimi i produkteve dhe prodhuesve që janë kërkuar. Nga nëntë tenderët që janë monitoruar në fazën e para-tenderimit, vetëm njëri prej tyre nuk ka pasur asnjë korrigjim të gabimeve në njoftime, përkatësisht kriteret teknike apo profesionale. Në tetë prej tenderëve të monitoruar, të paktën një herë ka pasur korrigjime të gabimeve përmes formularëve për korrigjim të gabimeve (B54). Në dy raste janë bërë nga gjashtë korrigjime të njoftimeve, kryesisht kishte ulje të kriterëve teknike apo profesionale, vetëm pasi ishin bërë ankesa nga Operatorë Ekonomik (OE).

Këto gjetje janë vizualizuar edhe përmes një infografike.

6. Partnerët dhe donatorët

Aktivitetet dhe rezultatet e mësipërme nuk do të ishin të mundura pa mbështetjen, përkrahjen dhe partneritetin e organizatave të ndryshme vendore e ndërkombëtare si: USAID, Zyra e BE-së në Kosovë, National Endowment for Democracy, UNDP, NDI, KAS, KCSF, GIZ, Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo, BIRN Kosovë.

Të gjitha raportet e auditimit të organizatës, përfshirë edhe atë për vitin 2023, janë të publikuara në faqen tonë të internetit: <https://dplus.org/per-ne/>.

